Aktualitet

Lezhë, hyinë për të vjedhur në banesë, grabitësit dhunojnë kryefamiljarin dhe bashkëshorten e tij! Flet pronari: Ishin të armatosur dhe të maskuar! Identifikohet një nga autorët

Një grabitje me dhunë ka ndodhur mbrëmjen e kaluar në Lezhë. Raportë Tv mëson se gjatë natës në fshatin Spiten, persona të paidentifikuar, kanë hyrë në banesën e shtetasit Gjergj Doçi për të vjedhur. Pasi janë hasur në rezistencë, grabitësit kanë dhunuar kryefamiljarin dhe bashkëshorten e tij shtetasen Vitore Doçi, 47-vjeçe

■ Dalin pamjet nga banesa që u grabit në Lezhë, çifti i bashkëshortëve përfundon në spital pas dhunës nga hajdutët

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
Sondazhet

HOROSKOPI

Redaksia
24 Maj, 07:41 | Përditësuar i fundit: 24 Maj, 14:59

Sh

LEZHË-Një grabitje me dhunë ndodhi në orët e para të mëngjesit të së hënës në një banesë në fshatin Spiten të Lezhës. Dy persona të maskuar dhe armatosur hynë për të vjedhur në shtëpinë e familjes Doçi, duke dhunuar me sende të forta burrë e grua.

Gjergj e Vitore Doçi u dërguan për ndihmë mjekësore në spitalin rajonal të Lezhës, por si pasojë e plagëve të marra gruja në ndodhet në gjendje më të rëndë dhe u transportua drejt spitalit të Traumes në Tiranë. Në momentin e ngjarjes brenda shtëpisë kanë qenë 5 pjesëtarë e familjes Doçi dhe fillimisht grabitësit kanë hyrë në dhomën e fëmijëve.



LEXO EDHE:
Përdhunimi i të miturës në Mirdite, do ekzaminohen celularët e vajzës dhe 5 të arrestuarve! 3 të tjerë në monitorim, dyshohen si të përfshirë në ngjarje

Kryefamiljari Gjergj Doçi thotë se kanë qenë në gjumë dhe kur kanë dëgjuar zhurmën janë zgjuar, duke ju kërkuar dy personave llogari se çfarë kërkonin në banesën e tyre, por janë përballur me dhunën babane të tyre. Banor të fshatit tregojnë se ngjarje të tilla ju kanë shtuar frikën, ndërsa i kërkojnë policisë që të zbardhe sa më parë atë çarë ka ndodhur dhe autoret të vihen para drejtësisë.

Në njoftimin zyrtar të policisë bëhet me dije se kanë arritur të marrin dy telefona celular dhe një sasi parash. Në vendngjarje janë fiksuar prova materiale të lëna nga autorët, të cilat do të shërbejnë për zbardhjen e ngjarjes. Policia sakaq ka shpallur në kërkim 23-vjeçarin Pavlin Dokaj, si një nga autorët e dyshuar të grabitjes me dhunë dhe po punon për identifikimin e autorit tjetër.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Tv Fundit

Ora 12:00
Zbardhet grabitja me dhunë në Lezhë, policia shpall në kërkim një 23 -vjeçar



Është zbardhur grabitja e banesës në Lezhë, ku dy shtetas grabitën me dhunë banesën e çiftit Doçi. Policia ka identifikuar dhe ka shpallur në kërkim një 23 vjeçar me iniciale P.D dhe po punon për të identifikuar një tjetër.

'Zbardhet ngjarja e ndodhur në Spiten, Lezhë, ku 2 shtetas vodhën me dhunë në banesën e një çifti bashkëshortësh.Identifikohet dhe shpallet në kërkim njëri prej autorëve.

'Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Lezhë, falë veprimeve të shpejta hetimore dhe punës intensive për zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes së ndodhur gjatë orëve të para të datës 24.05.2021, në Spiten, Lezhë, ku 2 shtetas i vodhën me dhunë një sasi lekësh dhe 2 aparate celularë shtetasve Gj. D., 57 vjeç dhe V. D., 47 vjeçe, bënë të mundur identifikimin dhe shpalljen në kërkim të njërit prej autorëve të dyshuar, shtetasi P. D.,23 vjeç, banues në Spiten, Lezhë.

Nga ana e Policisë vijon puna ndalimin e 23-vjeçarit P. D. dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit tjetër të dyshuar si i implikuar në këtë ngjarje, me qëllim vënien e tyre përpara përgjegjësisë ligjore dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarjeje.

Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale "Vjedhja me dhunë" kryer në bashkëpunim.' i njofton policia.

Ora 09:50
Më të qepura në kokë, pronari i banesës së grabitur në Lezhë tregon si ndodhi ngjarja: Ishin të maskuar dhe të armatosur! Më goditën me levë hekuri (VIDEO)

Gjergj Doçi, pronari i banesës së grabitur në Lezhë, ka treguar momentin kur u dhunua nga grabitësit në banesën e tij. Ai tregon se ato ishin të armatosur dhe njëri prej tyre kishte një hekur në dorë dhe e ishin të maskuar. Doçi, i cili ishte me të qepura në kokë nga dëmtimet që i kishin bërë, tha se nuk i njihte grabitësit.

'Sa isha ulur që të fle dhe dëgjova zhurmë. Dolën fëmijët duke bërtit. Unë kuptova se janë duke bërë shaka se pa kujtuë. Kur dola shoh dy veta me maskë të e me rroba të zeza. Njëri ishte me armë njeri kishte si hekur në dorë. U thashë kush jeni ju, pasta më goditë me hekur dhe rashë pa ndjenja. Nuk i njoha ishin me maska, bëra që të cohem më goditën prapa. Gruan e kanë dërmuar më shumë. Ku ka pyetë më thanë. S'kena lekë u thashë, merrni ça të gjeni. Kur gjeta ki kanë ikur në kënbë. Dolën jashtë pasi i morën, ato telefona lekët. Dola ti shoh nga ikin ikën kaluan avllinë.' - tha Gjergj Doçi.

Çifti i bashkëshortëve Gjergj e Vitore Doçi, të cilët u grabitën dhe më pas u dhunuan, nga persona të paidentifikuar kanë përfunduar në spital.

Burime bëjnë me dije se çifti ka marrë dëmtime nga dhuna e grabitësve. Ndërkohë Report Tv ka siguruar edhe pamje nga banesa e cila u grabit mbrëmjen e shkuar.

Një banorë i zonës tha se në zonë ka vetëm të moshuar.

'Këtu vetëm pleq ka. Të rinjtë janë jashtë shtetit. Ato janë në spital, kështu thonë kushërinjtë e vet. Këto punë si bëjnë këto, nuk janë njerëz, janë zero.' - u shpreh banori.



Pamje nga banesa e grabitur

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: grabitje hotha Arbnora e Vathrës Gjergj Doçi Vitore Doçi

Ndalohet ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A mendoni se në Shqipëri pandemia e COVID-19 mbaroi?
Po Jo Nuk e di
Komento

Lajme të tjera

Aktualitet



Nesër rishikohen masat/ Brataj: Fatale nëse i heqim të gjitha
26 Maj, 22:46

Aktualitet



'Defender 21'/ Ushtarakët marrin shënjestër në bazën e Pashalimanit, momente nga stërvitja
26 Maj, 22:42

Aktualitet



Vlorë-Orikum, ruga buzë detit e shembur prej 5 muajsh! ARRSH: Janë siguruar fondet, shpejt do nisë puna për rikonstruksionin
Armand Xhelili
26 Maj, 21:51

Aktualitet



Kryhen 12.621 vaksinime sot në vend, në total mbi 784 mijë vaksinime që nga fillimi i fushatës 'Shpërria Buzëqeshi'
26 Maj, 21:16

Aktualitet



Përdhunimi i 15-vjeçares në Mirditë, reagon Yuri Kim: Jo do të thotë joi Të dënohen abuzuesit
26 Maj, 20:41

Aktualitet



Përfundoi në spital me plagë në të dyja këmbët, plagosja e të riut në Vlorë pas një sherri në Lungomarei/ Shoqërohen disa persona
26 Maj, 20:26

© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pjesëtorizuar i kesaj faqeje